



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 31 janar 2020, në mbledhjen e XXVIII (njëzetetë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10:15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, (34 - Lista e nënshkrimeve, një anëtare e Kuvendit znj.Floretë Zejnullahu e cila ka dhënë dorëheqje të paravokueshme për shkak të zgjedhjes Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe Nënkryetari i Komunës z.Nexhmi Rudari, Drejtorët e Drejtorive, (DA; DI; DPUMM; DBF; DKA; DKRS; DPKGJ; DSHMS; DBPZHR), përfaqësuesja e OSBE-së znj.Shkendiza Kllokoqi, përfaqësues nga Shoqata Handikos – Podujevë, përfaqësues të mjeteve të informimit dhe mediave, si dhe disa prej zyrtarëve komunal.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke konstatuar kuorumin, përshëndeti të pranishmit, i njoftoj rreth pikave të rendit të ditës dhe rekomandimeve nga mbledhja e KPF-së e mbajtur, ndër të tjera shtoi,

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës dhe rekomandimeve nga KPF.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, para se të fillohet me punë, kam një propozim, dhe atë për arsye se para 23 viteve më parë ka qenë rënia e Heroit të Kombit Zahir Pajaziti, andaj propozoj që Kuvendi i Komunës të mbaj 1 minutë heshtje në shenjë respekti të jetës dhe veprës së Komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si dhe njeriut të veçantë të trevës tonë Zahir Pajaziti.

z.Bajram Ajeti, theksoi, mendoj që në ditën e njëjtë kanë rënë 3 Heronj të Kombit, Zahir Pajazit, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha, kështu që mendoj se është mirë që nderimin t’jua japim të tre Heronjve.

Kryesues i Kuvendit, e konsideroj me vend propozimin e parafolësve, dhe ftoj për 1 minutë heshtje, në shenjë nderimi për Tre Heronjtë.

Me rastin e 27 vjetorit të rënies së Tre Heronjve të kombit Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu, Edmond Hoxha, mbahet 1 minutë heshtje në shenjë nderimi të jetës dhe veprës së tyre.

1. Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më: 30 tetor 2019; 22 nëntor 2019; 05 dhjetor 2019 dhe 27 dhjetor 2019

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, siç keni vërejtur edhe në thirrje, kemi 4 ekstrakte të procesverbaleve, sigurisht keni pasë kohë të mjaftueshme t'i lexoni, andaj nëse keni ndonjë vërejtje, apo kërkesë për plotësim ndryshim në ndonjë prej diskutimeve, urdhëroni.

z.Adnan Zymeri, theksoi, kam vërejtur se në ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit e mbajtur më 05 dhjetor 2019 te pika e rendit të ditës për Raportin e diskutimit publik për draft Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit, konkretisht fjalimin që unë e kamë mbajtur, i është atribuuar që e ka mbajtur kolegu z.Bunjamin Hoti, andaj kërkoj të zëvendësohet me emrin tim sepse diskutimi ka qenë i imi.

Kryesues i Kuvendit, t'ju them të drejtën edhe unë e kam vërejtur këtë gabim të cilin po e quaj teknik ngase ka mundur të jetë gjatë bartjes së emrave apo në ndonjë formë të ngjashme, por mirë që u cek edhe nga vetë këshilltari që e ka mbajtur diskutimin – fjalimin. Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo i hedh në votim, në pako, Ekstraktet e procesverbaleve sipas kësaj pike të rendit të ditës, duke përfshirë edhe korrigjimin e emrit të diskutuesit siç u paraqit nga këshilltari parafolës.

Pas votimit, u konstatua se njëzëri miratohen Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më: 30 tetor 2019; 22 nëntor 2019; 05 dhjetor 2019 dhe 27 dhjetor 2019, me korrigjimin e gabimit që në ekstraktin e procesverbalit të datës 05 dhjetor 2019, te pika e rendit të ditës për Raportin e diskutimit publik për draft Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit, emri i "diskutuesit" z.Bunjamin Hoti të zëvendësohet e emrin e z.Adnan Zymeri.

2. Draft Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2022 në Komunën e Podujevës

➤ **Raporti i diskutimit / debatit publik**

z.Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit – DI, theksoi, meqë drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik z.Mirsad Kamerolli ka një rast sëmundje të papritur në familje dhe nuk ka mundur të jetë prezent në këtë mbledhje, ka kërkuar nga unë të paraqesë këtë fjalë hyrëse rreth kësaj pike. Prandaj po i përcjellë mesazhet e drejtorit që ky raport është bërë nga diskutimi dhe debati publik dhe si dokument, Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2022 kërkohet të miratohet sipas materialit të dërguar, i cili sigurisht që ju është dërguar me kohë dhe keni pasë kohë të mjaftueshme ta lexoni dhe analizoni. Ky dokument është përgatitur ndër të tjera edhe duke marrë për bazë të gjitha diskutimet e mëparshme por edhe pas shqyrtimit të parë në Kuvend e që rekomandimet dhe propozimet e dhëna janë inkorporuar. Gjithashtu edhe kontributin e këshilltarit z.Vendenis Lahu është shqyrtuar, andaj ky dokument është final dhe kërkohet nga Kuvendi ta shqyrtoj, analizoj dhe në fund të vendos për miratimin apo jo të kësaj Strategjie e cila ndër të tjera përcakton vizionin e Komunës së Podujevës për tri vitet e ardhshme.

z.Avni Fetahu, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së e përkrahu draft Strategjinë në fjalë duke përfshirë edhe raportin përcjellës që është i bashkëngjitur me material duke arsyetuar që është vërejtur qartë se ka aktivitete dhe masa konkrete n'kuadër të SZHEL dhe duke uruar që ashtu siç është harmonizuar me Kornizën Afatmesme Buxhetore – KAB të përcillet me projekte konkrete si dhe duke cekë që ne si Grup i këshilltarëve të LDK-së do ta përcjellim me vëmendje vit pas viti realizimin e të gjitha aktiviteteve dhe masave të parapara për secilën Drejtori veç e veç.

z.Vendenis Lahu, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së potencoj se kjo Strategji, pa dyshim është një ndër dokumentet më të rëndësishme e cila paraqitet në Kuvendin e Komunës për shqyrtim. Duke përfshirë sfidat, problemet dhe vështirësitë që përballen qytetarët e Komunës tonë janë të mëdha dhe të ndryshme duke filluar nga papunësia, varfëria, arsimi, shëndetësia dhe deri tek degradimi urban dhe ambienti, prandaj edhe nga ky dokument duhet të dalin qëllime strategjike dhe të parashihen politika dhe masa që duhet të ndërmerren për realizimin e tyre andaj edhe si Grup i LVV-së ka propozuar dhe mbështetur propozim vendimin për vënie në debat publik të kësaj draft Strategjie, debat në të cilin pjesëmarrja ka qenë e vogël, unë personalisht kam paraqitur disa propozime të cilat do ta pasuronin këtë dokument dhe do të paraqitnin në mënyrë të drejtë kërkesat e qytetarëve, propozimet ishin: 1-krijimi i një fondi prej 500,000.00€ në vit për subvencionimin e normave të interesit për kreditë investive në lëmin e prodhimit, 2-grante për bujqësi mbështetje për blerjen e makinerive prodhuese të industrisë ushqimore, pra do të krijohet një fond nga ku bizneset do të investojnë në makineri prodhuese e që do të ndihmoheshin me 30% të prodhimit, 3-propozimi tjetër ishte për arsim përkatësisht parashikim i investimeve për laboratorë të shkencave natyrore në vlerë 200,000.00€ për 20 shkolla të Komunës së Podujevës, 4-investime në zhvillimin e shkollave profesionale, krijimi i firmave ushtrimore dhe kabineteve si dhe hapjen e profileve të reja ose mbylljen e disa profileve bazuar në nevojat e ekonomisë e që për krijimin e këtyre politikave do të nevojitet një fond prej 300,000.00€, 5-ndërtimi i pesë terreneve sportive multifunksionale në pjesë të ndryshe të qytetit, si dhe 6-funksionalizimi i kinemasë së qytetit.

Në vazhdim theksoi, në këtë dokument që na është sjellë për miratim, hartuesi duke u bazuar në arsyet e që mendoj se nuk janë të bazuara dhe nuk janë përfshirë asnjë prej këtyre propozimeve, shembull, mos përfshirja e propozimit të parë, me arsyetim se nuk e parasheh KAB, nuk bënë shumë sens ngase kjo Strategji nuk buron nga KAB por anasjelltas, pastaj propozimi dytë e kemi propozuar si fond shtesë për mbështetje të prodhimit bujqësorë si jetik për zhvillimin e bujqësisë, mandej edhe propozimi jonë i tretë do të furnizonte 20 shkolla me laborator kurse me atë të Komunës pajisen vetëm 5 shkolla e që mendoj se nuk janë të mjaftueshme sepse jemi në vitin 2020, gjithashtu edhe propozimi për firma ushtrimore dhe kabinete do të ishte i domosdoshëm ndërsa arsyetimi se fillimisht duhet bëhet analizë e tregut është jo i qëndrueshëm sepse pavarësisht drejtimeve që do të hapeshin do të ketë nevojë për firma ushtrimore dhe prandaj ky arsyetim nuk është i qëndrueshëm.

Meqë propozimet tona si LVV, e që i konsiderojmë shumë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik shoqërorë por që nuk janë inkuadruar në këtë Strategji, ne nuk do ta votojmë për.

z.Bashkim Sylja, në emër të grupit të këshilltarëve të PDK-së potencoj se si fazë fillestare për hartimin e një strategjie duhet të mblidhen gjitha të dhënat për secilin sektor dhe të paraqitet gjendja reale. Grupi i këshilltarëve të PDK-së e mbështet këtë Strategji ngase mendojmë se kontribuon zhvillimit të gjithmbarshëm të Komunës së Podujevës, mirëpo kemi edhe disa vërejtje, dhe atë, tek arsimi edhe pse është përmendur numri i stafit akademik sipas përgatitjeve shkollore nuk është dhënë një tabelë që të paktën me përqindje për nivelin e arsimimit të stafit akademik me qëllim që t'iu jepet mundësi për trajnime. Sa i përket shëndetësisë (pika 1.9 nënpikat 3.2, 3.3 dhe 3.4) flasim për analiza laboratorike që fillojnë të realizohen nga janari 2022, andaj dua të dijë nga drejtori i Drejtorisë përkatëse si e ka planifikuar këtë sepse kjo qeveri lokale ka mandat vetëm deri në fund të vitit 2021, si dhe në këtë strategji është cekur se Ambulantat stomatologjike ka pasur më së paku vizita kur dihet se janë të angazhuar 7 stomatolog, andaj duam të dimë pse ka kaq pak vizita.

Pastaj tek pika 1.7 flitet për përmirësimin e kushteve të jetesës me rrugë, kanalizim, ndriçim, andaj a është paraparë të investohet në bazë të dendësisë së banorëve sepse shumë lokalitete me numër të madh të banorëve po anashkalohen e që nuk është në rregull.

Tek bujqësia janë paraqitur të dhënat e bonitetit të tokës e që do të ishte mirë të paraqitej një gjë e tillë më së largu deri në fund të vitit 2021 me qëllim që këto të dhëna të shfrytëzohen nga bujqit.

Pra ashtu siç e theksova edhe në fillim të diskutimit, në Grupi i këshilltarëve të PDK-së e mbështesim edhe përkundër defekteve që ka kjo Strategji por që më mirë është ta kemi një dokument të tillë se sa të mos kemi fare.

Kryesues i Kuvendit, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën e hedhi në votim dokumentin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2022 në Komunën e Podujevës, përfshirë edhe Raportin e diskutimit/debatit publik.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstaton se me 24 vota për, 7 vota kundër dhe 1 votë të përmbajtur, miratohet Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2022 në Komunën e Podujevës, përfshirë edhe raportin nga diskutimi/debati publik, i cili inkorporohet në dokumentin final të Strategjisë.

3. Propozim vendimi për vënie në shqyrtim publik Projekt – Harta Zonale e Komunës së Podujevës për periudhën 2020-2028.

- ***Akti i vlerësimit të përputhshmërisë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.***

z.Hamdi Jaha, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, jemi duke punuar që dy vite për draftin e Hartës Zonale të komunës së Podujevës dhe tani jemi në fazën finale, përkatësisht në fazën kur duhet të vëhet në diskutim publik dhe të mbahen debate publike me qytetarë, për edhe dëshiroj t’ju njoftoj që gjatë hartimit të draftit në fjalë kemi mbajtur diskutime publike në 5 lokalitete të ndryshme të Llapit (Kërpimëh, Lluzhan, Sfeçël, Orllan dhe në Podujevë) nga të cilat banorët e atyre fshatrave kanë dhënë kontribut të madh në përgatitjen e këtij dokumenti. Gjithashtu duke falënderuar Organizatën Gjermane GIZ me të cilën Komuna ka edhe Marrëveshje të Mirëkuptimit për hartimin e Hartës Zonale, në fazën e dytë të përgatitjes po ashtu kemi mbajtur diskutime publike me qytetarë ku numri i pjesëmarrësve ka qenë më i madh se sa në fazën e parë.

Kemi përgatitur një draft para final të dizajnit të Hartës Zonale, dokument të cilin e kemi paraqitur në mënyrë të detajuar edhe para komisionit ndërministror i përbërë prej përfaqësuesve të 4 Ministrive, të cilët pastaj e kanë shqyrtuar dhe analizuar këtë dokument dhe në fund na është sjellë një dokument nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i cili ju është dërguar të gjithë juve, sipas të cilit Komunës së Podujevës i jepet pëlqimi që të vazhdoj më tutje për procedim në Kuvendin e Komunës dhe vënie në diskutim publik.

Në mbledhjen e KPF-së jemi pajtuar që shqyrtimi publik i Projekt Hartës Zonale të Komunës të zgjatë nga 04 shkurti 2020 deri më 04 mars 2020 kurse debati publik të mbahet më 21 shkurt 2020 në ora 13:15 në sallën e mbledhjeve të kuvendit në ndërtesën e vjetër të komunës, për shkak se ka hapësirë më të madhe për pjesëmarrje të qytetarëve.

Kërkohet që sot të diskutohet për këtë projekt dokument, për çfarëdo që ju intereson, të paraqiten të gjitha çështjet që mendoni se është e nevojshme të sqarohemi, dhe në fund të miratohet vendimi për vënie në shqyrtim publik sipas rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pra unë jam këtu për t’ju dëgjuar dhe eventualisht për të dhënë përgjigje dhe sqarime të nevojshme, por që edhe jemi të hapur gjatë gjithë muajit të diskutojmë për këtë dokument duke mos përjashtuar

edhe mundësinë që secili prej juve të vini në zyrat e DPUMM gjatë orarit të punës të paraqitini pakënaqësitë, propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet e juaja.

z.Avni Fetahu, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, meqë propozimi si i tillë është vetëm për ta vënë në diskutim publik projekt Hartën Zonale të Komunës ne e mbështesim propozim vendimin në fjalë duke përfshirë edhe rekomandimin nga mbledhja e KPF-së. Gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik dhe në debatin publik me qytetarë ne do t'i japim sugjerimet, propozimet dhe opinionet tona lidhur me këtë dokument.

z.Bajram Ajeti, në emër të Grepit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, t'ju them të drejtën nuk kemi arritur shumë të trajtojmë këtë dokument meqë dokumenti si i tillë është shumë voluminoz, por megjithatë kemi arritur të fitojmë përshtypjen se është bërë një punë e mirë dhe është bazë për një dokument të domosdoshëm për Komunën tonë dhe zhvillimin ekonomik të saj.

Prandaj meqë është dhënë mundësia që për një muaj, përkatësisht nga 04 shkurti deri më 04 mars 2020 të qëndroj në diskutim publik dhe do të mbahet edhe debat publik, ne do të përpiqemi të japim kontributin tonë pas një analize pak më të thellë që do t'ia bëjmë duke konsultuar edhe ekspertët e kësaj fushe në mënyrë që edhe gjatë debatit t'i paraqesim vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tona me shkrim. Edhe pse ka qenë premtim që ky dokument do të sjellët në muajin qershor të vitit të kaluar dhe do të jetë parakusht për ndarjen e zonave për funksionalizimin e Rregullores për këshillat dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane, e që presim që edhe ai dokument të sjellët së shpejti për miratim meqë ka kaluar gjitha procedurat paraprake dhe ka mbetur vetëm shqyrtimi dhe miratimi i saj nga ana e Kuvendit të Komunës.

z.Rafet Llapashtica, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, e mbështesim propozim vendimin për vënie në diskutim publik të projekt Hartës Zonale të Komunës dhe konsiderojmë se është dokument shumë i rëndësishëm i cili i kontribuon Komunës së Podujevës.

Pajtohem me kohëzgjatjen e diskutimit publik dhe datën e debatit publik por ashtu siç diskutuam edhe në KPF, në bazë të mundësive financiare dhe mundësive tjera të përdoren edhe mediat lokale dhe medime të ndryshme që pjesëmarrja e qytetarëve dhe interesimi i tyre të jetë sa më i madh në mënyrë që dokumenti final të jetë në harmoni me gjitha kërkesat dhe interesat e qytetarëve.

Po ashtu është mirë që edhe ne si këshilltarë dhe si subjekte politike që jemi të japim kontributin tonë qoftë individualisht qoftë përmes ekspertëve tanë që kemi me qëllim që finalizimi të jetë në dobi të qytetarëve të Komunës së Podujevës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, me që nuk ka të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, sa vërejta është konstatim i të gjithëve se ky dokument është njëri prej akteve më të rëndësishme të Komunës për 8 vitet e ardhshme dhe që është konstatim edhe i këshilltarëve që të jepet kontribut nga të gjithë duke përfshirë edhe Shoqërinë Civile, andaj e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.

Pas votimi Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratua propozim vendimi për vënie në shqyrtim publik projekt Hartën Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën 2020-2028, duke përfshirë Aktin e vlerësimit të përputhshmërisë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, përkatësisht që diskutimi publik të zgjatë 30 ditë, përkatësisht nga data 04 shkurt 2020 deri më 04 mars 2020, ndërsa debati publik me qytetarë të mbahet më 21 shkurt 2020 duke filluar në ora 13:15 në ish sallën e mbledhjeve të Kuvendit në objektin e vjetër të Komunës.

4. Propozim Rregullorja për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

➤ Raporti i diskutimit / debatit publik

z.Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit – DI, edhe për këtë pikë të rendit të ditës sërish në mungesë të drejtorit të DPZHE, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, duke mos dashur t’ju marrë kohë ju ftoj ta miratoni raportin mbi diskutimin/debatin publik rreth propozim Rregullore për orarin e punës së bizneseve, përkatësisht Rregulloren në fjalë. Në raport janë përfshirë të gjitha rekomandimet dhe plotësim ndryshimet të paraqitura nga ana e qytetarëve, grupeve të interesit dhe atyre të rekomanduara në shqyrtimin e parë të këtij dokumenti por edhe ato nga mbledhja e KPF-së.

z.Bunjamin Hoti, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, lidhur me orarin e punës së bizneseve në faza të caktuara kemi dhënë kontributin tonë dhe tani kur ky dokument ka kaluar fazën e diskutimit publik dhe në këtë akt janë inkorporuar edhe idetë e bizneseve lokale në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së i japim mbështetje propozim Rregullore për orarin e punës së bizneseve që të merre formën e një akti i cili do t’i shërbente bizneset lokale dhe klimën e të bërit biznes në Komunën e Podujevës. Po ashtu konsiderojmë se përmes kësaj rregulloreje ne si asamblistë i japim shtytje shtesë çështjes së zhvillimit ekonomik dhe të bërit biznes në Komunën e Podujevës.

z.Bajram Ajeti, në emër të grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, në muajin qershor 2019 është miratuar vendimi sipas të cilit kjo rregullore ka dalë në debat publik dhe lidhur me këtë raport nga debati publik unë kam disa çështje. Mendoj se debati publik është bërë njëanshëm ngase janë përfshirë vetëm bizneset gjë që nuk mund të pajtojmë me këtë emërtim, nuk janë kontaktuar apo nuk është bërë debat me sindikatat e punëtorëve. Realisht ne në konceptin tonë politikë mbrojmë të drejtat e punëtorëve dhe shtresat e mesme dhe ato të ulta, por me orientimin tuaj politik po shihet se mbron vetëm biznesmenët, palët e klientelizmit që keni me ata dhe debati është kryer vetëm me ata, prandaj mendoj që është i njëanshëm.

Çështja tjetër, mendoj se në raport, nuk guxon, dhe për shkak edhe të obligimit Kushtetues të përmenden disa fjalë/terme (syfyrat etj) e që mendoj se këto nuk guxojnë të gjejnë vend në një akt juridik siç është kjo propozim rregullore. Gjithashtu duhet të mendojmë se kjo rregullore duhet të jetë në pajtim edhe me Ligjin e punës i cili rregullon marrëdhënien e punës në sektorin publiko – privat dhe të shikohet që do të jetë detyrë edhe e inspektoratit sepse fundja kjo rregullore ka për qëllim edhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të cilët shpesh herë janë edhe në pozitë skllavëruese gjë që është edhe e ndaluar me Kushtetutë, pra dihet që orari është 8 orë, dihet që iu takon pushimi për ç’lodhje, pastaj i takon pushimi 48 orësh, prandaj të mos bëjmë një rregullore dhe faktikisht prap të vazhdoj ende pozita e pavolitshme e tyre të cilët shpesh kam besim që edhe në Komunën tonë nuk posedojnë kontrata dhe nuk i realizojnë të drejtat e tyre themelore nga marrëdhënia e punës. Lidhur me emërtimin e kësaj rregulloreje, me theks kur thuhet, orarin e bizneseve, unë mendoj se do të ishte më mirë që titullimin e kësaj rregulloreje ta kemi, Rregullore komunale për caktimin e orarit të punës për subjekte afariste në Komunën e Podujevës, e jo të bizneseve sepse mendoj se është term më i drejtë dhe më i përgjithësuar ngase përfshinë të gjitha fushat e afarizmit. Pra unë kaq kisha rreth kësaj pike, breng e jona është tek punëtorët sepse edhe oraret duhet të përshtaten dhe do të jetë edhe detyrë e jona të mbrojmë edhe punëtorët që mos të diskriminohen me orare të zgjatura por ashtu siç është përcaktuar me ligj dhe kam besim se Drejtoria e Inspeksionit që është përgjegjëse për këtë çështje do ta ketë parasysh respektimin e Ligjit të punës n’raport edhe me orarin e punës ngase fundja orari i punës është i përcaktuar edhe me ligj.

z.Fatmir Rudari, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, e përkrahim këtë propozim rregullorë dhe shpresojmë të gjejë zbatim veçmas dita e diel të jetë ditë pushimi edhe në Komunën e Podujevës.

znj.Adelinë Stublla, paraqiti pyetje sa i përket orarit të punës së barnatoreve private, theksoi, kur kemi parasysh nevojat dhe kërkesat e pacientëve sidomos në kujdestaritë e natës pasi që në shumicën e rasteve mungon terapia në QKMF dhe pacientët mbesin pa terapi si dhe për orarin e punës së stomatologjisë përkatësisht për kujdestarinë e natës pasi që në QKMF stomatologjia nuk kujdestaron natën por sa jam në dijeni unë as ordinancat private nuk kujdestarojnë.

znj.Mrika Thaqi, theksoi, fillimisht dëshiroj të jap vërejtjet e mia lidhur me përgatitjen e raportit mbi diskutimin publik me grupe të fokusura rreth kësaj rregulloreje e që është dashtë të bashkëngjiten të gjitha detajet e takimeve siç janë, vendi i takimit, kohëzgjatja e takimit, lista e pjesëmarrësve, procesverbalet e takimeve ashtu siç janë cekur në hyrje të raportit. Pastaj janë edhe disa vërejtje teknike të cilat mendoj se duhet të shqyrtohen, mendoj se një dokument zyrtar i një institucioni nuk duhet të parasheh veprimtaritë e ndaluara ekonomike në vend siç është rasti ku në nenin 9.3 ku parashihet orari i punës për bastore, duke qenë në dijeni se bastoret janë mbyllur, pastaj në nenin 8 kur flitet për hotelet, nëse e zbërthemë fjalinë teknikisht i bie që hotelet nuk mund të punojnë në asnjë orë sepse orarin e punës e kanë 00:00 deri në ora 24:00, kurse pas orës 24:00 nuk u lejohet më shërbim për mysafirët jashtë, andaj ku ka nevojë për një interval që përcakton kohën e ndaluar të shërbimit. Në bazë të përcaktimit të definicioneve në këtë rregullorë, për definicionin e orarit të punës neni 3 pika 1, ka kuptimin e detyrimit që bizneset t'i përmbahen orarit të caktuar sipas rregullores e që unë mendoj se duhet të përshtatet definicioni i orarit të punës duke cekur se orari i punës ka kuptimin e maksimumeve të vendosura në rregullorë e që ka biznese edhe sezonale.

Pastaj kur thuhet që në bazë të diskutimit publik është vendosur që qendrave tregtare, supermarketet dhe dyqanet ushqimore me pakicë u është zvogëluar orari i punës, kurse dyqaneve të tekstilit, këpucëve etj, u është zgjatuar orari i punës me qëllim të arritjes së një lloj barazie, mendoj se është në kuadër të një koncepti të gabuar ekonomik, andaj mendoj se duhet pasur kujdes sepse edhe brenda kategorisë së parë ka dallime mes qendrave tregtare dhe supermarketeve e që mendoj se nuk është përfaqësuar drejtë marrja e kërkesave të tyre, mendoj se këto kategori duhet trajtuar në mënyrë të barabartë sa i përket kohëzgjatjes së punës, por ajo çka duhet ta rregulloj këtë pjesë është se duhet të jetë një taks e vendosur, jo vetëm me një kriter të vendosur që është ora, por duhet të jenë dy kriterë, ora shtesë dhe kapaciteti i biznesit.

Andaj duke konsideruar se nuk janë reflektuar realisht mendimet e bizneseve, nuk është ofruar asnjë lehtësi në kuadër të kompetencave të shumë bizneseve që po pengohen për shkak të shumë punimeve të përsëritura në qytet, mendoj se kjo rregullorë e hartuar në këtë formë nuk është në funksion të përmirësimit të asnjë situatë. Konsideroj se me përmirësimet e nevojshme teknike dhe konceptuale të rregullores duhet miratuar me shpresën që së pari të rregulloj sa do pak klimën e biznesit dhe të kontribuoj në klimën sociale, dhe së dyti të mos rrisë potencialin shantazhues të inspektorëve ndaj biznesit duke pasë parasysh pamundësinë reale të zbatimit të rregullores në tërësi sot për sot.

z.Hasan Ajeti, theksoi, kjo propozim rregullorë qëllim primar ka përcaktimin e fillimit dhe mbarimit të orarit të punës, ditët të cilat detyrohen respektivisht punojnë dhe ditët kur nuk punojnë të gjitha bizneset apo shoqëritë që ushtrojnë veprimtaritë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Podujevës. Pra me këtë dokument përcaktohet orari i punës për të gjitha subjektet për të cilat edhe sot jemi të thirrur këtu që të nxjerrim këtë akt, të cilat pastaj gjithë pronarët dhe personat privat, e kanë të rregulluar në fushveprimtarinë e kësaj rregulloreje.

Sa i përket të drejtave të punëtorëve që u tha se ka rrezik të shkelen, unë besoj që kjo çështje rregullohet edhe dispozitat e Ligjit të punës e që organet kompetente të Komunës janë të përcaktuara karshi kësaj rregulloreje që të monitorojnë respektivisht të bëjnë zbatimin e kësaj rregulloreje.

Po ashtu në rast se ka emërtime të paqarta në këtë rregullore ashtu siç u shprehën më parë, duhet të përmirësohen në mënyrë që të mos ketë pastaj paqartësi sa i përket interpretimit të normave të kësaj rregulloreje.

z.Zaim Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, theksoi, sqarim rreth çështjeve të ngritura nga këshilltarja znj.Adelinë Stublla lidhur me baranoret dhe stomatologjinë. Ne detaje ndoshta nuk ka qenë e nevojshme të bashkëngjitet në raport por ne kemi një orar të punës të caktuar nga vetë pronarët e barnatoreve me të cilin përcaktohen tri kritere që na kanë munguar. Sigurish jeni në dijeni se orari i punës në institucione private shëndetësore, ne nuk mund të lëshohemi t’ju imponojmë përveç orarit të rregullt të punës që përcaktohet me Ligjin e punës, por për hir të gatishmërisë së tyre dhe humanizmit që kanë, absolutisht për neve ka qenë e mirëseardhur orari i përgatitur nga vetë ata dhe i cili përmban tri çështje, kujdestarinë e natës, për ditët festive dhe ditët e diela, e që ne absolut kemi gjete kënaqësi rreth kësaj çështje kur ata vetë kanë gjetur këtë gatishmëri dhe t’i përgjigjen këtij orari i cili me siguri do të jetë publik por që më shumë do t’iu shërbej drejtorive dhe institucioneve tjera përkatëse që do të jenë përgjegjës për mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së atij orari.

Sa i përket çështjes së stomatologjisë, dëshiroj t’ju njoftoj që duke punuar në atë drejtim që të organizohet edhe çështja e mjekut stomatolog ngjashëm ashtu siç e kemi organizuar çështjen e mjekut familjarë në kuadër të QKMF. Besoj që shumë shpejt do të rregullohet kjo çështje dhe qysh kohë më parë ka qenë disponim i yni që kjo të rregullohet mirëpo besoj që për shkaqe të kufizimeve që kemi me resurse dhe buxhet nuk kemi mundur deri më tani ta realizojmë kujdestarinë e natës për shërbimin e stomatologjisë e që ndoshta na duhet që të angazhojmë me shërbime të veçanta një stomatolog deri sa të zgjidhet çështja e resurseve.

z.Avni Islami, theksoi, meqë jam këtu në foltore po shfrytëzoj rastin të paraqes disa çështje me qëllim që të mos marr fjalën pastaj 2-3 herë tjera. E përsëritës nismën për rregullimin e orarit të punës së bizneseve dhe uroj të respektohet kjo rregullore përkatësisht orari i punës, por jo sikurse ligji për duhanin. E them këtë ngase në Komunën e Podujevës të merr malli të gjesh ndokund një lokal ku nuk pihet duhani, prandaj uroj që të ndërmerret diçka nga përgjegjësit që të respektojnë ligjin i cili ndalon pirjen e duhanit në vende të mbyllura me theks në lokale.

Në seancën e kaluar kam kërkuar që të vendoset Flamuri Kombëtar këtu së këtë sallë, kjo meqë për fat të mirë nuk kemi nacionalitete tjera por të gjithë jemi Shqiptarë do të ishte mirë të vendosej këtu së bashku me këtë të Shtetëror.

Po ashtu një shqetësim që deshta të ngriti e që besoj se është edhe shqetësim i juaji, fjala është për aksin rrugor prej rrugës kryesore deri tek semaforët, shenjzimi i vijave të komunikacionit mendoj se nuk është duke funksionuar si duhet, edhe pse nuk jam ekspert i komunikacionit, mendoj se ka mundësi që të evitohen ato probleme ngase shiriti i anës së djathtë i cili del prej qytetit nuk i plotëson kriteret që të jetë funksional, pra vijat e vendosura janë jashtë funksionit, madje sa herë që kaloj andej ka mundësi të më dënoj policia për shkak se shiriti është shumë i ngushtë dhe është e pamundur që në atë pjesë të vozisë ndokush në gjendje normale. Përveç kësaj kam një propozim që në atë pjesë të rrugës që është hapësirë e mjaftueshme në të ardhmen të vendoset një shirit për biçikletat dhe këmbësorët. Pra këto ishin disa shqetësime të ngritura në emrin tim dhe në emër të Ballit Kombëtar.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj parafolësin për çështjet e ngritura edhe pse ato çështje ishin për pikën të ndryshme. Vërejtjet dhe sugjerimet e juaja besoj se do të merren parasysh. Urdhëroni nëse ka këshilltarë tjerë për të marrë fjalën, nëse jo e hedh në votim propozim rregulloren për orarin e bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës, respektivisht raportin mbi diskutimin publik për këtë dokument duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri miratohet raporti mbi diskutimin publik përkatësisht miratohet Rregullorja për orarin e punës së bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës, duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

5. Propozim vendimi për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, Ndërmarrja Regjionale për Menaxhimin e Mbeturinave “Pastrimi” ka një strukturë ka një organizim dhe një bord menaxhues i përbërë prej drejtorëve të bordit ku secila Komunë pjesëmarrëse në këtë ndërmarrje e që janë 7 Komuna përfaqësohet nga një Komision i aksionarëve i përbërë prej tre anëtarëve, 2 nga Kuvendi dhe 1 nga Ekzekutivi i Komunës përkatësisht nga Kryetari i Komunës, përbërje kjo e cila dërgohet njëjtë nga Komunitat pavarësisht terrenit, numrit të banorëve etj. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit dhe ndërmarrjeve publike janë të përcaktuara me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjit për shoqëritë tregtare, andaj kërkohet nga Kuvendi të propozohen dhe të emërohen dy anëtar/e, ndërsa pastaj Kryetari i komunës me vendim të veçantë emëron edhe një anëtar nga Ekzekutivi i Komunës.

Përgjegjësitë e komisioneve komunale janë të përcaktuara siç e cekta me legjislacion përkatës ku ndër të tjera miratojnë politika të ndërmarrjes, bordit të drejtorëve etj, prandaj edhe kërkohet që anëtarët të jenë profesionistë të fushës së menaxhimit të mbeturinave apo fushave të ngjashme menaxheriale, dhe të jenë aktiv varësisht takimeve të organizuara nga vetë ndërmarrja.

z.Avni Fetahu, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, duke marrë parasysh që për anëtarë në këtë komision kërkohet përgatitje profesionale, ne si Grup nga radhët e LDK-së propozojmë znj.Liridona Shabanin dhe z.Afrim Shabani.

z.Bajram Ajeti, në emër të grupit të Këshilltarëve të LVV-së, theksoi, sa i përket komisionit të aksionarëve vërejtja se ka njëanshmëri që anëtarët të jenë të një subjekti politik. Për efikasitetin e atyre që kanë qenë më parë e tha edhe vet drejtori parafolës se nuk kanë treguar asgjë. Fillimisht mendova që edhe opozita është mirë të jap kontributin e vet duke marrë parasysh që çështja e mjedisit dhe trajtimit të mbeturinave në përgjithësi në Komunën tonë jeni në dijeni se në çfarë gjendje është, kështu që unë doja të propozoja znj.Doruntina Hasani për anëtare në komisionin përkatës, mirëpo sugjeroj që para datës 03 shkurt të bëhemi më tolerant për çështje të tilla.

z.Rafet Llapashtica, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, t’ju them të drejtën edhe pse në parim u pajtuam si Grup i këshilltarëve të PDK-së që mos të kemi propozim fare për anëtar në këtë komision në mënyrë që të japim hapësirë ndonjë subjekti tjetër politik opozitar të dërgoj përfaqësuesin e tyre. Pra është mirë që të paktën një anëtar të jetë nga opozita, jo i PDK-së sepse ene kemi përfaqësues në dy komisioni të tilla (Stacioni i autobusëve dhe Ndërmarrja banesore).

Mu duk jo e mirë propozimi që dy anëtar të jenë nga LDK-ja, dhe tani në një formë nuk po mbetet as të diskutohet më për këtë çështje sepse shumicën e ka LDK-ja dhe e voton por ne si PDK jo nuk e

votojmë një gjë të tillë, për hir të demokracisë. Nëse pajtohemi që një anëtar të jetë nga subjektet opozitare, cila do qoftë, po do ta votojmë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa për sqarim parafolësit, pati një propozim nga ana e Grupi i LVV-së. Pra kemi propozimet e dhëna, nëse nuk ka të tjera shkojmë me votim.

z.Bajram Ajeti, theksoi, a ka mundësi që propozimi i LDK-së të mos hedhet në votim ashtu siç u prezantua, por të përfshihet edhe propozimi jonë që ishte, pra të kalojnë dy kandidatet femra, dhe të mbyllet kjo çështje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, shkojmë me votim, sipas radhës që ishte, kush është për propozimin e parë znj.Liridona Shabani dhe z.Afrim Shabani.

z.Fatmir Rudari, theksoi, ashtu siç e potencoj edhe z.Rafet Llapashtica, për shkak të zhbllokimit të kësaj situatë do të ishte mirë që LDK të tërheqë njërin kandidat, dhe të shkojmë në votim për dy kandidatët e propozuar, njëri nga pozita dhe njëra nga opozita. Përndryshe tregona formulën se si po votohet në mënyrë që pastaj të shohim ne a po marrim pjesë në votim apo jo.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, e hedh në votim propozimet ashtu siç u prezantuan sipas radhës, pa paragjykuar se do të votohet, përndryshe mund të hedhim në votim një nga një, dhe kështu po vendosim.

Njëzëri u mbështet znj.Liridona Shabani, për anëtare në Komisionin përkatës të aksionarëve.

17 vota për, 4 vota kundër, dhe 11 vota të përmbajtura ishin për z.Afrim Shabani.

16 vota për, ishin për Doruntina Hasani.

Kryesuesi i Kuvendit, konstatoi se znj.Liridona Shabani dhe z.Afrim Shabani anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike - Kompania Regionale e Mbeturinave "Pastrimi" sh.a.

6. Kërkesa për ndihmë financiare e Qendrës së Rehabilitimit Bazuar në Bashkësi 'HANDIKOS' – Podujevë

z.Zaim Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, e paraqiti kërkesën në fjalë, ndër të tjera theksoi, edhe për vitin 2020 kemi një kërkesë për mbështetje financiare Handikosin – Podujevë. Për rëndësinë, punët dhe aktivitete që bëjnë kjo organizatë besoj se të gjithë jeni në dijeni, prandaj për punët specifike, detyrat dhe angazhimet që ka mendoj që edhe përkundër vështirësive financiare që kemi është mirë dhe ftoj të mbështetet edhe në këtë vit, me atë shumë ashtu siç kanë kërkuar.

z.Agron Hyseni, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së vlerësojmë pozitive punën dhe angazhimin e vazhdueshëm të OJQ-së Handikos – Podujeva. Se a i plotëson kjo shumë e mjeteve nevojat e kësaj kategorie shoqërore, themi se jo por më mirë të themi plotëson nevojat e mbijetesës, por duke pasur parasysh numrin e madh të anëtarëve ekzistues dhe rasteve të reja që identifikohen në vazhdimësi dhe që duhet të kenë ofrim të shërbimeve të ndryshme. Me një përkrahje më të madhe të kësaj kategorie sa do pak do ta përmirësonim statusin e tyre në shoqëri dhe do të përmbushnim detyrimet tona për të cilat populli na ka besuar me votën e tyre, dhe po ashtu të dëshmojmë për objektivat që kemi ndaj qytetarëve. Grupi i këshilltarëve të LDK-së e voton këtë propozim dhe mendojmë se është një mbështetje e vogël në krahasim me nevojat që ka kjo kategori e shoqërisë.

z.Vendenis Lahu, në emër të grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, ne e mbështesim ndarjen e mjeteve financiare për OJQ Handikos dhe rithekojmë rëndësinë e ofrimit dhe trajtimit të barabartë

të kësaj kategorie të shoqërisë. Komunën, brenda kompetencave të veta, e inkurajoj që të përdorë të gjitha kapacitetet saj që t'ju ofroj lëvizje të papenguar, shërbime shëndetësore dhe mundësi punësimi sipas ligjeve në fuqi.

Në Komunën e Podujevës janë mbi 900 persona nga kjo kategori, pra kemi një komunitet të cilin duhet ta integrojmë sepse nuk kanë nevojë për mëshirë e as përkujtim por kanë nevojë për integrim të plotë në shoqëri duke përfshirë të gjitha sferat. Ata persona nuk duhet të jenë barë e familjes por duhet të jenë përgjegjësi e shoqërisë.

Po ashtu inkurajoj Komunën që të mbështesë organizatat tjera si motra, siç janë ajo e autizmit dhe ajo me Sindrom Down.

z.Fatmir Rudari, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së theksoi, edhe ne do ta përkrahim këtë shumë simbolike ta quaj kështu për Handikos, kategori kjo e cila mendoj se duhet të trajtohet çdo ditë nga Komuna e jo vetëm me këtë shumë.

znj.Mrika Thaqi, theksoi, realisht e kemi një kërkesë të Handikos e që besoj se nga të gjithë do ta ketë mbështetjen. E gjithë ajo çka mund të them është se a jemi duke mundur t'i përkrahim mjaftueshëm këtë kategori të personave, si dhe duke uruar që të gjinden edhe forma dhe mënyra tjera për përkrahjen e tyre.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, unë e hedh në votim kërkesën në fjalë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, me vendim miratohet kërkesa e Qendrës së Rehabilitimit Bazuar në Bashkësi "HANDIKOS" – Podujevë, sipas materialit përkatës dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

7. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për përfundimin e periudhës së parë të vitit shkollor 2019/2020

z.Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, e paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 18/2019 për kalendarin e vitit shkollor, periudha e parë e vitit 2019/2020 ka përfunduar më 30 dhjetor 2019.

DKA, në funksion të përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2019/2020 ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të krijuar kushtet për mbarëvajtjen e vitit të ri shkollor. Shikuar në përgjithësi periudha e parë e vitit ka përfunduar me sukses ku gjatë kësaj periudhe kohore shtator – dhjetor 2019 janë realizuar të gjitha punët dhe detyrat e planifikuara sipas dinamikës së paraparë n'kuadër të niveleve të arsimit parauniversitar, por edhe punë dhe detyra të paraqitura gjatë kësaj periudhe kohore. Në vitin shkollor 2019/2020 në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë, janë të rexhistruar 16349 nxënës të sistemuar në 786 paralele. Bazuar në raportet e dorëzuara nga drejtorët e shkollave mbi suksesin e arritur në periudhën e parë të vitit rezulton se suksesi më i lartë është në arsimin fillor me notën mesatare 4.27, pastaj pason arsimit i mesëm i ulët me notën mesatare 3.27 dhe arsimit i mesëm i lartë me notën mesatare 2.65. nga kjo që u tha më lartë konkludojmë se nota mesatare në nivel komune për periudhën e parë të vitit shkollor 2019/2020 është 3.39 e që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi një ngritje të lehtë prej 0.14% të notës mesatare.

Edhe gjatë vitit 2019 zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit kanë zhvilluar vizita sistematike në të gjitha institucionet edukativo arsimore për të monitoruar dhe përkrahur drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit në mënyrë që të avancojmë me cilësinë e arsimit në Komunën e Podujevës.

DKA në bashkëpunim me MASHT edhe këtë vit ka vazhduar trajnimin për të gjithë mësuesit të cilët nuk e kanë përfunduar ende trajnimin për zbatimin e Kurikulës së re, bashkëpunim i cili do të vazhdojë edhe në të ardhmen varësisht si paraqiten nevojat nga mësuesit.

Gjithashtu sikurse edhe viteve tjera DKA, përkatësisht Komuna e Podujevës ka siguruar transportin për të gjithë nxënësit të cilët kanë distancë të largët nga shtëpia në shkollë dhe për fëmijët me nevoja të veçanta të cilët i vijnë në mësimet në paralelet e shkollës “Kongresi i Manastirit”.

DKA edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar bashkëpunimin me partnerët e saj qoftë lokal qoftë edhe ata ndërkombëtar, vlen të ceket Organizata ndërkombëtare GIZ me të cilën kemi një bashkëpunim të mirë e që viteve paraprake kemi qenë edhe fituese e projektit Iniciativa e ekselencës – Komunë gjithëpërfshirëse, mirëpo bashkëpunimin me këtë organizatë e kemi vazhduar edhe me një projekt tjetër gjatë këtij viti me projektin, Shkollat Kampion, ku nga Komuna e Podujevës janë tri shkolla të përfshira në këtë projekt, të cilat do të mbështeten nga kjo organizatë qoftë me trajnime, qoftë me punëtori të ndryshme por edhe me mjete mësimore.

Gjithashtu duhet të ndaj një informatë edhe me ju se falë bashkëpunimit përmes Memorandumit të Bashkëpunimit që ka DKA me projektin Alleb 2, harmonizimi i arsimit dhe aftësimin me nevojat e tregut të punës, projekt ky i cili është shumë serioz i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim e që në kuadër të këtij projekti janë të përfshira 20 shkolla dhe që ka pas fatin e mirë të përfshihet edhe shkolla teknike “Fan Noli” e që është një projekt shumë serioz dhe pritet që kjo shkollë të përfitojë shumë nga ky projekt qoftë me trajnime për mësuesit qoftë me kabinete me mjetet të nevojshme për zhvillimin e praktikës profesionale

Gjithashtu edhe në arsimin para fillor kemi një projekt që tani edhe pritet edhe të nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit me Organizatën Zvicerane Caritas, ku në kuadër të një numri të kufizuar të komunave në këtë vit është përfshirë edhe Komuna e Podujevës e që ka të bëjë me trajnimin e stafit të edukatoreve për parashkollor por edhe pesë klasë do të pajisen me të gjitha mjetet mësimore që i duhet këtyre nxënësve të kësaj grup moshe e që në kudër të këtyre pajisjeve do të participojnë edhe Komuna e Podujevës me një shumë prej 30% të projektit.

Gjithashtu edhe projekti për përmirësimin e sistemit të arsimit, ku 2 vitet e kaluara kemi qenë të përfshirë me 9 shkolla nga granti i Bankës Botërore, këtë vit vetëm se e kemi përfunduar, por që dy vitet e kaluara shkollat kanë përgatitur planin zhvillimor të shkollës, kanë planifikuar aktivitetet dhe trajnime për shkollat si dhe kanë si dhe kanë planifikuar t’i pajisin shkollat me mjete mësimore, pavarësisht se si e kanë parë të nevojshme, projekt i cili ka përfunduar në dhjetor të vitit 2019.

Në kuadër të projekteve kapitale për vitin 2019, veç jeni të informuar që kemi bërë përrurimin e shkollës “Dituria” në fshatin Llapashticë e Poshtme ku nxënësve të asaj shkolle dhe stafit mësimor pedagogjik iu kemi krijuar kushte jashtëzakonisht të mira për zhvillimin e procesit mësimor.

Gjithashtu shkolla “Emin Duraku” në fshatin Bajçinë po thuajse është në përfundim dhe vetëm pritet edhe inventarizimi i saj nga MASHT e që shpresojmë se shumë shpejt edhe kjo çështje shumë shpejt do të zgjidhet dhe do të mundësohet që mësimi të zhvillohet në hapësirat e reja të shkollës.

Po ashtu në vitin 2019 kanë filluar punimet edhe për ndërtimin e shkollës “Elfir Behrami” në fshatin Metehi e që do të vazhdojë edhe gjatë këtij viti dhe të përfundojë në vitin 2020, si dhe ka filluar të ndërtohet shkolla “Kadri Kadriu” paralelja në fshatin Llaushë të Poshtme.

Gjithashtu janë zhvilluar edhe disa projekte nga Komuna, qoftë në rregullimin e ambientit të brendshëm qoftë në sanimin e disa dëmeve dhe defekteve që kanë qenë, pastaj vlen të ceket rregullimi i sallës së edukatës fizike në shkollën “Fan Noli”, pastaj rrethojat në disa shkolla etj.

Po ashtu kemi ndërtuar edhe tri terrene sportive gjatë vitit 2019 me të cilat nxënësve të atyre shkollave iu janë krijuar kushte për lëndën e edukatës fizike edhe në aspektin praktik, mandej janë pajisur dy shkolla Gjymnazi “Aleksandër Xhuvani” dhe shkolla “Naim Frashëri”, me laborator për

shkenca natyrore, mandej është bërë instalimi i kamerave të sigurisë në disa prej shkollave si dhe shumë punë dhe aktivitete tjera të cilat nuk po dëshiroj ti përmend të gjitha me rend.

Mbesim të përkushtuar edhe në këtë vit që planifikimet tona me përkushtimin më të madh ti realizojmë të gjitha.

znj.Lirika Maliqi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, me të shfletuar këtë informatë nga DKA, të dendur në sasi e bosh në përmbajtje mund të vërejmë që këtu mungojnë informacione shumë të domosdoshme, shembull, mungesat e nxënësve, ku askund nuk ka ndonjë të dhënë lidhur me numrin e mungesave gjatë gjysmë vjetorit të kaluar, pastaj mungojnë informacionet për stafin e shkollës, pra nuk dihet nëse ka pasur konkurse, a ka pasur të punësuar apo të pensionuar, apo e keni fshehur kur dihet se të gjitha konkuret në arsim bëhen në baza politike. Meqë jemi te stafi, a jeni në dijeni që ka punëtor teknik i cili punon deri ne 12 orë brenda ditës.

Thuhet se janë mbajtur trajnime të ndryshme, pse nuk keni specifikuar çfarë trajnimesh dhe me cilat kriteret kanë përfituar mësimdhënësit. Mandej keni cekur bashkëpunimet me Organizata të ndryshme, si të arritura të DKA-së, mirëpo nëse dikujt i atribuohen meritat për këto projekte, atëherë më së paku i atribuohen DKA-së në Podujevë dhe këtë e them me përgjegjësi te plotë.

Po ashtu thuhet se disa shkolla janë pajisur me printer dhe fotokopje, por për cilat shkolla behet fjalë, a jeni në dijeni ju si drejtor i DKA-së që nxënësit në shkolla fillore dhe jo vetëm, edhe pse pagesat janë te ndaluara me ligj, ata janë të detyruar t'i paguajnë me paratë e veta fotokopjimin e testeve sepse një mundësi të tillë nuk ua ofron shkolla në të cilën vijnë mësimin.

Ju nuk keni qenë në gjendje t'i plotësoni kushtet elementare të një shkolle, siç është një printer i vetëm, e mos të flasim për mungesën e bibliotekave nëpër shkolla sepse është një nivel tejet i avancuar për ju. Vlerësimi që i bëni librit dhe dijes tregon më së miri mungesa e bibliotekës së qytetit për pothuajse 2 vite tashmë. Gjithçka që keni realizuar është bërë me standarde minimale.

Në komunën tonë ende ka shkolla që ngrohen me dru, kurse investimet kapitale nuk i keni orientuar në përmirësimin e inventarit të shkollës, të ambientit dhe të sallave të sportit. Oborret e shkollave u ngjajnë fushave nëpër të cilat kullosin bagëtia. Pastaj keni theksuar se ka shumë investime kapitale, ndërsa sipas raportit 9 mujor të vitit 2019, investimet kapitale nuk e kalojnë as 10%, pra nga 534,000.00€ janë shpenzuar vetëm 31,127.00€.

Vlen të ceket që nuk ka asnjë informacion për Këshillat Drejtues të Shkollave, kush është zgjedhur, me çfarë baze dhe çfarë kriteresh, a do të thotë kjo që kemi të bëjmë me preferenca personale të drejtoreve të shkollës, e aq më keq kur dihet që si Komunë njihemi me përbërje prej pothuajse 100% të drejtoreve politik. A mendoni që të gjitha këto çështje, sipas informacioneve e kanë lënë Podujevën si Komunën nën mesataren e nivelit të Kosovës në testin PISA.

Nga të gjitha shkollat sa ka Komuna jonë, pse nuk e fut si informatë, sa psikologë i kemi nëpër shkolla, sa biblioteka i kemi nëpër shkolla, sa laboratorë dhe kabinete të informatikës kemi, sa salla të sportit i kemi etj. Këto dhe shumë e shumë probleme të tjera, po t'ia shtonit, do ta pasuronin shumë informatën tuaj dhe ta pasqyronin gjendjen reale të arsimit.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, fillimisht ju përgëzoj drejtor për përkushtimin tuaj për precizitetin tuaj lidhur me sjelljen e raportit / informatës, por disi sikurse të jetë copy paste nga vitet e kaluara me asnjë ndryshim për të mirë, duke filluar në cilësinë e arsimit testi PISA dështim, asnjë risi për pajisje me laboratorë për lëndët profesionale, asnjë fotokopje për nxënësit dhe mësimdhënësit lidhur me përgatitjet e testeve duke qenë në dijeni se tani me Kurikulë të re nxënësit kanë më shumë teste se sa viteve paraprake. Kabinetet për lëndët e matematikës duam ta dimë sa shkolla janë të pajisura me laboratorë, ku i vijnë praktikën nxënësit e shkollave profesionale, pastaj është cekur për disa renovime të shkollave por asnjëherë nuk është cekur me pajisjen e shkollave me biblioteka të

shkollës apo kënde të leximit. Dhe në fund i nderuar drejtor përse asnjëherë nuk raportoni për nxënësit parashkollor të Çerdhes së vetme publike si dhe një raport nga shkollat profesionale.

z.Blerim Maçastena, theksoi, më 03 shtator 2018 e kam ngritur si shqetësim gjendjen e disa shkollave në Komunën tonë. Investimet kapitale, nga të gjitha ato shkolla që i kam ngritur si shqetësim, e vetmja shkollë që ka përfituar prej këtij rasti është paralelja e ndarë në Dumnicë të Epërme “Kadri Kadriu”, kurse shkollat tjera nuk kanë përfituar nga shqetësimi im, edhe pse nuk do të thotë që ju duhet të merrni të gjitha shqetësimet tona por me të vërtetë gjendja e disa shkollave që i kam përmendur është shumë e rëndë.

Mirëmbajtja e objekteve shkollore është prap një sfidë të cilën ju nuk po mundeni ta përballoni, kemi objekte të reja shkollore të cilat janë të pa mirëmbajtura. Nëse në vitin 2018 drejtor nuk keni pasë njohuri për objektet shkollore sepse vetëm sa pati marrë mandatin e drejtorit apo ushtrues detyre siç ke qenë, nuk mund ta arsyetoni veten në vitin 2020 se nuk i njihni objektet shkollore, madje ju duhet të dini për gjitha shkollat që janë në Llap, por nëse i njihni dhe nuk keni investuar në shkollat; në Bellopoj, Lluga, Gërdoc, Dumosh, Lladoc, Pollatë, Surdull, e shumë të tjera, atëherë është për keqardhje kjo punë. Si Komunë keni premtuar ndërtimin e shkollës në fshatin Dumosh, ju lus ta realizoni sepse banorët janë duke ju pritur. Për fund, ju kam dëgjuar më parë që keni thënë se kuadrot emërohen me profesionalizëm, por drejtor a ka mundësi të na tregoni çfarë profesionalizmi keni parë te drejtori i shkollës në Bradash që e keni emëruar para disa muajve.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, dëgjuam raportin e DKA-së dhe si dihet edhe botërisht se gjendja e arsimit është në nivel të ulët dhe me shumë sfida dhe e dëshmuar edhe me raportet vendore dhe ato ndërkombëtare, gjendje kjo si pasoj e shumë faktorëve, me theks të veçantë edhe si pasoj e keq menaxhimit që bëhet në Komunën tonë dhe punësimeve në baza partiake nga partia që udhëheq me Komunën. Edhe ky rezultat i prezantuar para nesh e dimë se nuk vie nga një vlerësim i drejtë dhe sipas meritës, edhe pse i rritur në vlera përsëri është shumë i ulët për nivelin që e kemi në mënyrë që fëmijët tanë të jenë konkurrent me komunat e tjera pasi ta mbarojnë mësimin fillor dhe të mesëm.

Për të folur për nivelin e arsimit dhe parregullsitë në Komunën e Podujevës është e lehtë, shembull, ka kuadro shumë profesionale që nuk janë lejuar dhe janë diskriminuar për tu bërë pjesë e arsimit në Podujevë, e kjo vie vetëm pse nuk kanë qenë pjesë e partisë që vendos për këto punësime, rezultatet e dobëta janë pasoj, shkak është se Drejtorja e Arsimit në Podujevë bënë shkelje ligjore dhe nuk i respekton Udhëzimet Administrative që janë obligime për të, e që unë do t'i cekë disa me radhë.

Sipas Udhëzimit Administrativ 32/2013 për organizimin e Kurikulës me zgjedhje, përveç ndarjes së orëve zgjedhore që zakonisht bëhen me intervenca dhe për plotësime norme, në shkollat e Podujevës nuk respektohet edhe neni 10 i këtij udhëzimi i cili parasheh vlerësimin për orët zgjedhore me notë numerike kurse në Komunën tonë ky vlerësim vazhdon të bëhet ende me shkronja me çka ka humbur interesimin e nxënësve për këto lëndë e që kjo ndikon direkt tek nxënësit. Po ashtu sipas vlerësimit të MASHT nr.20/018 të datës 11.02.2019 është bërë obligative vendosja e kutive të ankesave në secilin objekt shkollor në mënyrë që t’iu jepet mundësi për ankesa secilit nxënës apo prindë, pa pasur frikë që do t’ju hakmerret në notim nxënësve që bëjnë këto ankesa, ndërsa ne fatkeqësisht kemi shkolla në Komunën e Podujevës që nuk janë vendosur këto kuti të ankesave.

Pastaj duke iu referuar Udhëzimit administrativ 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasje të personave me aftësi të kufizuar, është obligative që secili objekt shkollor të posedoj shiritin për qasje me karroca dhe kushte të tjera për fëmijët me nevoja të veçanta pa të cilët pamundësohet gjithë përfshirja e nxënësve gjë të cilën e parasheh edhe Kurikula dhe ligjet në fuqi që i cekët edhe ju më parë, e për këtë DKA në Podujevë nuk ka bërë asgjë në këtë drejtim.

Një çështje tjetër shumë e rëndësishme që ka të bëjë me sigurinë e nxënësve dhe stafit të mësimdhënësve në shkolla është edhe vendosja e aparateve kundër zjarrit dhe mirëmbajtja e

shkallëve emergjente në secilin objekt shkollor në rast të fatkeqësive natyrore, shpërthimeve nga zjarri apo ndonjë emergjencë tjetër e që në shumicën e objekteve shkollore të Komunës së Podujevës nuk ekziston apo nuk mirëmbahet për të qenë e shfrytëzueshme, ani se është shumë e rëndësishme.

Po ashtu asnjëherë nuk janë udhëzuar nxënësit se si të sillen në rast të fatkeqësive emergjente, natyrore dhe nuk din se si të sillen në raste të fatkeqësive të tilla, çështje kjo e cila rregullohet edhe me Rregulloren 24/2012 për normat teknike për mbrojtjen nga zjarri të objekteve të larta, dhe po ashtu Ligjin nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, konkretisht neni 13.

z.Vendenis Lahu, theksoi, kam një pyetje për drejtorin e DKA-së, realisht përsëritje e pyetjes që kamë para kësaj seance por që nuk kam marrë përgjigje, prandaj po e ritheksoj sërish, çfarë duhet të ndërmarrë DKA për përmirësimin e gjendjes në arsim në Komunën tonë, pas rezultateve të PISA ku është treguar performancë nën mesatare edhe në nivel vendi.

Pyetja tjetër është, nëse drejtori i DKA-së ka ndonjë raport se cilat lektyra apo romane i kanë lexuar nxënësit e shkollave të Komunës së Podujevës me të cilat menaxhon Drejtoria përkatëse, pra nëse ka ndonjë raporte për këtë do të doja ta shihja.

z.Hasan Ajeti, theksoi, drejtori i DKA-së paraqiti një informatë lidhur me punën e DKA-së në Komunën e Podujevës. Është normale që të ketë vërejtje dhe shqetësime mirëpo të thuash se krejt është vetëm zi, ky besoj se është emërtim puro politik. Sa i përket punësimeve që u përmenden se janë nga strukturat e LDK-së, unë shtroj pyetje, me çfarë baze keni nxjerrë këtë konstatim që gjithë të punësuarit në DKA janë të LDK-së kur dihet që edhe në mesin tonë kolegë anëtarë të Kuvendit janë edhe pjesë e arsimit e që nuk janë të LDK-së.

Sa i përket cilësisë dhe vlerësimeve tjera është shumë normale që ky problem nuk është vetëm në Komunën tonë por është në nivel të Republikës së Kosovës, andaj të nxirren konstatime të tilla, konsideroj se janë puro, të pastërta dhe me elemente politike.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, kam pyetje për drejtorin e DKA-së, fjala është për shkollën “Emin Duraku” në fshatin Bajçinë, për të cilën në fillim të vitit ka thënë se më së largu 1 muaj ajo shkollë do të hapet dhe do të jetë e gatshme për proces mësimor, andaj përse edhe tani po thuhet se është në përfundim dhe a do ta thoni të njëjtën gjë sërish në muajin shtator.

znj.Mrika Thaqi, theksoi, sot kur kemi në rend dite një informatë të DKA-së dhe për të cilën po debatohet unë në cilësinë e këshilltares së Kuvendit të Komunës kam dilema se a kemi një raport pune apo një informatë, këtë e them duke u nisur nga fakti që informatat nuk votohen e që tek raportet është e kundërta, por meqë po debatohet unë dëshiroj të vë në spikam disa çështje të cilat besoj se do të duhej të gjenin vend qoftë në informatë qoftë në raport.

Në këtë informatë janë të paraqitura shumë mirë disa aspekte që kanë të bëjnë me nxënësit, shembull, numri i nxënësve të tri niveleve edukativo arsimore që funksionojnë në Komunën tonë, mandej sukcesi i tyre i treguar gjatë kësaj periudhe kohore dhe në këtë aspekt unë do të doja që kjo informatë të përfshinte; 1-ndarjen e bursave, a janë ndarë bursa dhe nëse janë ndarë, sa, si dhe qysh, 2-duke parë një dukuri që gjithandëj Kosovës është bërë aktuale e që besoj se edhe në komunën tonë është e njëjta gjendje, fjala është për lëvizjen dhe braktisjen e procesit mësimorë të nxënësve qoftë si arsye e migrimit të tyre jashtë vendit qoftë edhe për arsye të tjera, a do të ishte mirë ta dijmë se cili është numri i nxënësve dhe që tani më nuk janë nxënës të shkollave të Komunës së Podujevës dhe pse jo edhe një krahasim edhe me periudhën paraprake.

znj.Endritë Murati, theksoi, me kujdes kam lexuar informatën e paraqitur nga DKA për përfundimin e periudhës së parë të vitit shkollor 2019/2020, para së gjithash vlerësoj çdo punë dhe angazhim të dobishëm të stafit mësimdhënës dhe udhëheqëses nëpër shkollat e Komunës së Podujevës, por edhe të zyrtarëve tjerë komunal. Nga ana tjetër dëshiroj të shpreh shqetësimin tim se qytetit i Podujevës ende vazhdon të ketë vetëm një institucion parashkollor publik në të cilin mund të

vendosen fëmijët nën moshën 5 vjeçare, ndërsa për kohë të gjatë jemi në dijeni se ekzistojnë kërkesa dhe nevoja të shumta të qytetarëve që të rritet numri i institucioneve publike ku do të mund të regjistroheshin fëmijët e moshën nën 5 vjeç, kërkesë kjo e shumë familjeve që janë të shtyrë nga nevoja për punësim të prindërve të rinj, çështje kjo e cila shumë herë është ngritur edhe këtu në Kuvend nga disa prej kolegëve por deri më tani këto kërkesa nuk janë reflektuar në planet investive të Ekzekutivit, përkatësisht në buxhet e të cilat gjithmonë janë aprovuar pa u miratuar nga Kuvendi. Impakt arsimor, kulturor e social i rritjes së institucioneve të tilla të arsimit parashkollor është tejet i lartë dhe prandaj Komuna do të duhej ta konsideronte si një investim strategjik me ndikim mjaft pozitiv në shumë drejtime, nga ana tjetër dua të nënvizoj disa aspekte për mua të rëndësishme lidhur me informatën në tërësi. Kjo Informatë e paraqitur sot para Kuvendit, për aq sa është synuar të përfshihet në përmbajtje është korrekte, mirëpo unë me mirëkuptim do të parashtroja disa vërejtje lidhur me shtrirjen e përmbajtjes së kësaj informate gjithmonë duke vlerësuar këtë në kuptim të obligimit që ka Ekzekutivi i Komunës të respektoj më shumë autoritetin e Kuvendit të Komunës. Natyrisht që ne si anëtarë të Kuvendit duhet të informohemi për ato që janë realizuar për periudhën raportuese, mirëpo ne duam të dimë më shumë rreth asaj se çfarë është synuar të arrihet dhe sa është arritur konform këtij relacioni, pastaj duam të dimë se nga periudha e kaluar raportuese e deri më tani në cilin nivel kemi qenë dhe në cilin jemi, cilat sfida ka qenë në gjendje t’i adresoj kjo Drejtori kundrejt resurseve që ka disponuar dhe ku janë ngecjet. Këto shpjegime konsideroj se i mungojnë informatës pasi që nuk janë mohuar në mënyrë të intensifikuar dhe analizuar.

Çdo informatë e mirëfilltë aq më tepër kur i drejtohet një institucioni që ka funksionet e veta monitoruese sikurse që është Kuvendi i Komunës n’raport me Ekzekutivin e Komunës, do të duhej t’i përmbahej të gjitha këtyre kriterëve që pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen që e kemi në sektorin e arsimit. Jam e bindur se kështu do të reflektohet në mënyrë më të mirë e dhe punë e Drejtorisë dhe ne do të ishim në gjendje të zhvillonim një debat më përmbajtësor lidhur me situatën aktuale që kemi në nivelin e arsimit parauniversitar në Komunën tonë.

z.Avni Islami, theksoi, fillimisht e përgëzoj drejtorin e DKA-së i cili gjatë mandatit të tij është duke u përpjekur të jap maksimumin e tij që shkollat të jenë sa më të përgatitura dhe po mundohet të jetë në shërbim të tyre, por që unë kam pyetje, jo për sot ndoshta por kurdo që mund të jap përgjigje drejtori, fjala është kur jemi në dijeni se shkollat tona kanë mungesë të madhe të infrastrukturës logjistike siç janë kompjuterët dhe pajisje të tjera në drejtime përkatëse dhe salla të ndryshme, dua të them këtë sepse nuk jam në dijeni sa duhet, a janë në kuadër të Komunës apo duhet Komuna të ndaj një buxhet të caktuar apo ndoshta përfaqësuesit e Komunës ta paraqesin si kërkesë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, kjo për shkak se kujtoj që kjo është një kosto bukur e lartë dhe nuk di a do të mund të përballonte Komuna këtë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, falënderojmë drejtorin për informatën e dhënë dhe gjendjen e dhënë përmes kësaj informate ngase përmes kësaj informate Kuvendi e sheh gjendjen dhe gjendja është ajo qysh është paraqitur por unë do të doja të ndalem pak më konkretisht. Si parametra të gjendjes në arsim duhet të dimë, cilësia në arsim a është rritur prej vitit të kaluar apo jo, pastaj siguria nëpër shkolla a është rritur apo është e njëjta, infrastruktura shkollore a është rritur apo është e njëjta, mandej stafi akademik është me përgatitje profesionale apo nuk është, dhe tani kur ndalemi në këto pyetje konkrete dhe në bazë të raportit që e ka sjellë drejtori i DKA-së del që nota mesatare nuk është rritë, do të thotë e kemi 2.65 e që i bie mjaftueshëm sa për ta kaluar vitin në shkollat e mesme dhe maturantët e vitit shkollor të cilët synojnë të mbarojnë vitin dhe të regjistrohen në fakultete e që do të jemi skeptik secili prej nesh se a do të mund t’i kalojnë testet kombëtare dhe testet e pranimit nëpër fakultete, prandaj unë mendoj se kjo duhet ta shqetësoj drejtorin i cili i jap orientimin arsimit në Komunën tonë. Shkolla “Fan Noli” e ka 2.18 e ka notën mesatare, “Isa Boletini” 2.53 dhe

Gjimnazi pak më të ngritur 3.24. dhe tani nëse ndalemi te ajo që e tha këshilltari z.Hasan Ajeti, puro politika, aspak mua personalisht nuk më intereson një drejtor politik, drejtorin e shkollës vendoseni të LDK-së sepse e keni pushtetin, por vendosni drejtor profesionist, pastaj shkarkojeni edhe drejtorin e LDK-së nëse doni të ngritni notën mesatare në shkollën “Fan Noli” në mënyrë që të mos mbetet nota mesatare e njëjtë me ish drejtorin Avni Maloku.

Mendoj se prej gjysmë vjetori në gjysmë vjetor, drejtori i DKA-së duhet të na informoj apo të na raportoj se gjendja në arsim është duke u ngritë, e jo duke treguar regres sepse nuk mund të hyjmë në vitin 2021 me një regres në arsim, me një infrastrukturë më të keqe në arsim, kurse me buxhet duke u rritë, pastaj nuk mund të hyjmë vitin 2021 me një staf akademik të tillë kur e dim që Podujeva ka doktor të shkencave, nuk mund të hyjmë në regres kur kapacitetet e sigurisë si në nivelin lokal si në atë nacional me institucione rriten duke pasë incidente dhe therje me thika apo rrahje nëpër oborre të shkollave, madje jo nga nxënësit por nga stafi akademik me nxënës e që është shqetësuese kjo gjë. Do të thotë që kjo mendoj se i jep detyrë drejtorit të drejtorisë së arsimit jo t’i delegoj inspektorët e arsimit por të jetë vetë personalisht në oborre të shkollave dhe të del nëpër të gjitha shkollat të shikoj gjendjen në arsim. Stafi akademik, rekrutimi i profesorëve apo intervistimi i drejtorit i cili e drejton shkollën dhe që drejton kërkesa tek DKA, duhet të bëhet në panel të hapur sepse nuk konkurron vetëm një por konkurrojnë shumë profesor, por jo të bëhet nëpër zyra të mbyllura intervistimi për drejtor apo profesor të fushave të ndryshme. Përndryshe të sjellë një intervistim drejtori i DKA-së të 10 kandidatëve për profesor për një lëndë adekuate këtu dhe t’i fton mediat dhe këshillin e prindërve që ata të shohin se cili është profesionisti i cili duhet të hyjnë në klasë dhe të ligjëron ngase nuk do të thotë vetëm ta kesh një diplomë por për ta edukuar dikë duhet të plotësosh edhe fusha dhe aspekte tjera qofshin ato morale, njerëzore, kombëtare por edhe intelektuale, mirëpo nëse një profesor bie në nivelin e nxënësit dhe rrahet me nxënës në oborr të shkollës ai nuk mund t’i jap model mësimi ndokujt, pastaj nëse një drejtor shkolle shikon të merr “vjedh” 1m dru për arsye të mjeteve financiare në vetë institucionin ku shërben ai nuk mund ta udhëzoj ndokënd se si mbahet arsimit, nëse një drejtor i arsimit për 2 vite e ka gjendjen e njëjtë në shkollë me infrastrukturë, me logjistik, me furnizim etj, nuk mund ta mbajë pozitën e drejtorit, përveç që mund t’i mundësohet politikisht por gjendjen ta përmirësoni jo.

Tani ajo që i mbetet Kuvendit, nuk jemi këtu vetëm që t’ju akuzojmë drejtor, por këtu jemi për t’ju ndihmuar, të paktën këtë e them personalisht, asnjë kërkesë nuk e keni sjellë që 2 vite për ta rritë buxhetin për ta përmirësuar gjendjen, por askënd nuk e keni infiltruar as e ke njoftuar në seanca të hapura të rekrutimit të panelit dhe stafit akademik që ke marrë në punë, vetëm të të shikojmë se si po intervistoni një profesor e që ndoshta nuk është qëndrim i juaji personal drejtor por nuk ke ndërmarr masa për përmirësim. Jam në dijeni se informata të tilla nuk votohen, por edhe jam në dijeni se nuk jemi këtu që të drejtojmë gisht në drejtim të ndokujt sepse nuk jemi në sallë gjyqi, kështu që për gjysmë vjetorin e dytë kërkoj që tani të dalësh të vizitosh shkollat drejtor, dhe për vënë keq gjithë këshilltarët e Kuvendit nëpër secilin lokalitet prej nga vijnë duke përfshirë edhe veten, të thërrasësh këshilltarët dhe t’ju tregosh se si ti vepron

Problemi tjetër është se nuk pati asnjë propozim konkret gjatë këtij debati se si mund të dalim prej kësaj gjendje, nuk do të thotë se krejt gjendja është e zezë, por të kemi një propozim konkret, shembull, t’ja rrisim buxhetin DKA-së apo cila është ideja e Kuvendit sepse në qoftë se nuk jemi të kënaqur me këtë gjendje po i bie që vetëm opozita po kritikon por edhe nëse një prind i ndokujt që jetë i kënaqur që fëmija i tij ta ketë notën mesatare 2.18, dhe të mos ketë gjendje të mirë infrastrukurore, atëherë edhe opozita është pjesë e këtij qyteti dhe pjesë e këtij vendi dhe mund të solidarizohemi me këtë, madje unë e di se ky fakt ju shqetëson edhe juve si drejtor personalisht, por jemi në vitin 2020 dhe duhet të shpreheni, shembull, do të duhej të kërkonit buxhet për projekte

të caktuar në Kuvend, e nëse ne nuk do t'ju mbështetnim do të duhej tani në pikën 9 që është raporti i punës së Kuvendit, ta thonit se ju kamë kërkuar buxhet dhe nuk më keni mbështetur, kështu që ju drejtor vet keni ndejtë paksa i tërhequr, për arsye tuat politike ngase nuk keni marrë guximin të propozoni buxhet e që besoj se të gjithë do ta votonim.

E di që asnjëherë nuk keni dal në terren, madje edhe në një prej seancave të kaluara ju kam thënë se që 2 vite si drejtor në asnjë shkollë nuk keni dalë të shihni nga afër gjendjen çfarë është. Vlen të theksohet se në vendin prej nga vi unë, asnjë orë e lëndës së edukatës fizike nuk mund të mbahet për shkak të gjendjes infrastrukturore, kurse në muajin qershor nxënësit lëshohen, ndërsa edukata fizike nuk mund të mbahet sepse gjatë procesit mësimor nuk kushte askund, as salla sportive, as fusha të mbyllura për tu mbajtur kjo lëndë, ndërsa profesori juaj merr pagë, edhe pse nuk ka çfarë të bëjë sepse nuk ka kushte, kështu që është mirë të dalësh pak në terren të jeni më aktiv, përndryshe këtë informatë ne po e pranojmë kështu siç është, mirëpo nëse vie edhe në shtator me të njëjtën gjendje, sërish po ta them që mos e sjellë fare ashtu sikurse ish drejtori Avni Maloku, përkatësisht ose përmirësojeni duke prekur pikat ku gjendja është më e mirë dhe disa aspekte tjera ku jeni më mirë e jo të sjellën informata me një gjendje të njëjtë.

Krejt këtë e them sepse është edhe në interes tonin sepse të gjithë i kemi fëmijët tanë nëpër shkolla, prandaj edhe e thash që jemi për t'ju ndihmuar jo për t'ju gjykuar.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pati një numër të madh të këshilltarëve që diskutuan dhe paraqitën vërejtje dhe kritika të ndryshme, andaj drejtor urdhëroni fjala për juve të jepni përgjigje dhe sqarimet e nevojshme.

z.Agim Blakçori, drejtor i DKA-së, theksoi, falënderoj të gjithë për kontributin e dhënë, ne jemi në dijeni se asambleja komunale përbëhet prej përfaqësuesve politik dhe deri në një masë është e lejueshme të bëhet edhe politikë sepse përfaqësoni qytetarët por megjithatë duhet t'i shohim gjërat ashtu si janë. I mirëpres të gjitha vërejtjet, kritikën, sugjerimet dhe ndoshta do të ishte edhe më e dobishme të zhvillonim edhe takime individuale për çështje të ndryshme, madje jemi dëshmitarë që disa çështje i kemi trajtuar me disa prej juve edhe në zyrë sepse kur është vullneti i mirë për t'i lëvizur gjërat gjejmë mënyra dhe forma t'i zgjidhim ato prandaj jemi jashtëzakonisht të hapur për këtë. U ngritën shumë çështje e që disa prej tyre nuk kanë të bëjnë me temën që po trajtohet sot në këtë pikë të rendit të ditës sepse kemi një informatë për periudhën e parë të vitit shkollor, se a ka ndryshime apo nuk, unë besoj se është fare thjesht dhe po t'ia lëshojmë me kujdes një sy kësaj informate do të vërehet se ka ndryshime dhe përmirësime në fusha dhe aspekte të ndryshme, kurse normal që nuk jemi të kënaqur. Jeni në dijeni se për investime kapitale, çështje të cilën e kemi ngritur edhe më parë, drejtpërsëdrejti është përgjegjëse Ministria përkatëse dhe si janë ndarë mjetet në të kaluarën nga ajo Ministri e dim të gjithë dhe uroj që Ministria tani e tutje, kushdo që vie në atë Ministri, ta ketë me prioritet arsimin, jo vetëm me deklarata por me seriozitetin më të lartë sepse kemi nevojë për investime jashtëzakonisht të mëdha në arsim, dhe tani po e parafrzoj një thënie të një mendimtari ku thotë që ta ndërtohet një shkollë dhe të kujdesesh që ajo shkollë të jetë bashkohore është më e vështirë se ta nisësh njeriun për në hënë, mirëpo Qeveria me politika të drejta ndaj Drejtorive të Arsimit në Komuna të caktuara dhe sistemit të arsimit në fushat ku ne i dimë më së mirë se cilat janë dobësitë e arsimit në Kosovë, dhe me një bashkëpunim të mirë të Ministrisë dhe Komunave në të ardhmen unë mendoj se shumë gjëra do të përmirësohen.

Pastaj u ngrit këtu edhe çështja e testit PISA, rezultati është ai që është dhe nuk mundemi ta akuzojmë një mësimdhënë, një shkollë ose një akter të vetëm, por kjo është si pasojë e disa vendimeve, disa politikave që ka marrë MASHT e që mësimdhënësit i kanë vënë në dilema të ndryshme, madje vetëm zbatimi i Kurikulës është një sfidë shumë e madhe për mësimdhënësit, pastaj drejtorët e shkollave dhe zyrtarët e arsimit nuk i kanë trajnuar me kohë, mësimdhënësit ju

kanë dërguar kohë pas kohe trajner e që ndoshta disa prej tyre ndoshta nuk kanë qenë profesional sa që kanë pas debate, dilema dhe vështirësi edhe gjatë trajnimeve, por megjithatë me një vullnet të hekurt të mësimdhënësve janë arritur disa gjëra, madje po ta paraqesim gjendjen e mësimdhënësve, drejtorëve të shkollave, dhe gjithë punëtorëve tjerë (mendoj se atyre iu hym në hak).

Megjithatë unë jam i hapur për të gjitha çështjet që ju shqetësojnë sepse ato pa dyshim janë edhe tonat si Komunë, qoftë për themelimin e Çerdheve qoftë përmirësimi i infrastrukturës, qoftë pajisja me kabinet mësimore, fusha sportive, etj, pra të gjitha këto shqetësime janë edhe shqetësime tonat dhe jemi të vetëdijshëm për këtë, sa për sqarim rreth asaj që u tha se a ka ndryshime unë po e përmendi vetëm çështjen e fushave sportive, kemi tri të reja që janë ndërtuar me aq buxhet sa kemi pasur andaj po të kishim buxhet më shumë jam i bindur që do të kryenim edhe më shumë punë.

Ajo çka mund t'ju siguroj juve dhe qytetarët është se jemi jashtëzakonisht të angazhuar qoftë si drejtori, qoftë si drejtor të shkollave, qoftë si mësimdhënës që t'i kryejmë të paktën detyrat për të cilat jemi të thirrur dhe ajo që unë personalisht ju them këtu publikisht është, nëse vërej që ndonjë gjë nuk është duke funksionuar ashtu si duhet në ndonjë shkollë, të jeni të bindur se unë do të ballafaqohem me atë problem ashtu siç edhe jam ballafaquar shumë herë deri sa e kam zgjidh, shkopin magjik nuk e kemi por me këto mundësi që i kemi do të mundohemi dhe do ta bëjmë më të mirën të mundshme. Uroj që edhe investimet kapitale në të ardhmen të orientohen drejtë, jemi një prej komunave të mëdha qoftë për nga territori qoftë sa i përket banorëve, nxënësve dhe objekteve shkollore. Po ashtu edhe mësimdhënësit të cilët kanë pasur vështirësi qoftë me norma qoftë me vende pune këtë vit mësimor që për shkak të rënies së numrit të orëve, janë ballafaquar me humbjen e vendit të punës, prandaj mund të bisedoni me ata mësimdhënës se me çfarë serioziteti e kemi trajtuar këtë problematikë, pa e politizuar fare dhe pa gjykuar fare në aspektin politik, jemi munduar t'ju bëjmë zgjidhje gjithë atyre punëtorëve të arsimit. Po ashtu te konkurset, edhe te regjistrimi i nxënësve, mund të merrni me mend se çfarë presioni kemi pasur në regjistrimin e nxënësve, me theks në paralelet e mjekësisë, dhe unë me përgjegjësi të plotë mund t'ju them se nuk ka pasë as më të voglën ndërhyrje prej askujt por ka qenë suksesi i tyre ku ata janë ranguar.

Edhe për çështjen e ngritur nga znj. Adelinë Stublla në mbledhjen e KPF-së po dëshiroj t'i japë sqarim rreth notës mesatare në paralelet e mjekësisë është 4.47.

Për fund edhe njëherë po ju them se e mirëpres çdo çështje që keni për të diskutuar kur do që e shihni të nevojshme.

z. Fitim Haziri, theksoi, fillimisht ju dërgoj falje se në këtë pikë dëshiroj të them diçka që ndoshta do të duhej të thuhej në pikën të ndryshme. Dëshiroj t'ju njoftoj se për mua ndoshta do të jetë seanca e fundit e imja si këshilltar në Kuvendin e Komunës së Podujevës ngase me formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nga opozita do të kalojmë në pozitë por si LVV do të vazhdojmë si opozitë në Komunën e Podujevës. Gjithashtu dëshiroj t'ju njoftoj se LVV ka vendos që shef i Grupit të këshilltarëve të LVV në Kuvendin e Komunës së Podujevës nga tani e tutje është Vendenis Lahu.

Për fund, ju kërkoj falje për çdo gjë e cila ka mund të tingëllojë si mosmarrëveshje apo ndonjë keqkuptim tjetër, por dëshiroj t'ju falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin që kemi pasë dhe shpresoj që ky bashkëpunim do të vazhdoj edhe prej pozite respektivisht nga qendra në Prishtinë.

z. Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, falënderoj parafolësin për kontributin e dhënë dhe bashkëpunimin e deri tanishëm dhe njëkohësisht i uroj suksese në nivel qendrorë / Kuvend të Republikës së Kosovës.

Theksoi, konsideroj se kjo pikë e rendit të ditës përfundoj, dhe kalojmë në pikën e radhës sipas rendit të ditës.

8. Informatë e Drejtorisë së Administratës lidhur me zhvendosjen e personelit punonjës në ndërtesën e re të Komunës

z.Gëzim Namani, drejtor i Drejtorisë së Administratës – DA, paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, pa dashur të përsëriti çështjet të cilat janë cekur në informatën e dërguar në formë të shkurtuar dhe që keni pasë kohë të mjaftueshme për ta analizuar. Meqë keni kërkuar një informatë të tillë dhe ju është sjellë.

Më 29 nëntor 2019 kemi filluar të bartemi nga objekti i vjetër i në ndërtesën e re të Komunës ku fillimisht është bartur Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë të cilët kanë kryer punë dhe detyra për qytetarë pastaj për të përfunduar me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave për shkak të obligimeve të fundvitit që ka pasë kjo Drejtori.

Jemi në dijeni se kushtet për punë janë shumë më të mira se sa kanë qenë në ish objektin, sidomos për ato zyra që kanë funksionuar në ish ndërtesat e ish Gjykatës dhe në ish Policisë së vjetër, dhe tani në këtë objekt është krejt diçka tjetër po nuk mund të themi se gjithçka është në rregull ende, por po e them se jemi duke parë funksionalitetin e ndërtesës dhe do të shohim se ku mund të ndërhyrë ku njëra prej tyre është edhe kjo çështja e zërimit në këtë sallë. Po ashtu u cek edhe vendi dhe hapësira ku u tha se është paksa e ngushtë mirëpo kështu është paraparë nga Komisioni Evropian ashtu siç janë paraparë edhe në 4 objekte tjera të ngjashme në komuna tjera të Kosovës, madje Fushë Kosova dhe Obiliqi i kanë edhe më të vogla, kurse Vushtrria dhe ne Podujeva i kemi më të mëdha sepse edhe objekti është P+2. Gjatë gjithë kohës ne si Komunë kemi përcjellë ndërtimet dhe kemi paraqitur vërejtjet dhe shqetësimet tona dhe ja ku jemi tani. Komisioni Evropian është në përfundim të kontratës dhe vetëm jemi duke pritur një raport me shkrim prej tyre se çka do të vie si përfundim.

E di që ka vërejtje në disa çështje, por ajo që mund të rrumbullakoj është se jemi duke parë funksionalitetin e objektit të ri të Komunës dhe pastaj do të bëjmë një analizë dhe do të ndërhyrë aty ku e shohim të nevojshme, përndryshe këtu jam nëse keni ndonjë pyetje apo çështje për tu sqaruar me gjithsecilin prej juve.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, dëgjuam drejtorin parafolës dhe edhe po nga ai vërejtëm se ka disa pakënaqësi, por deshta të them diçka se po thuajse të gjitha Komunitat e Republikës së Kosovës kanë një bashkëpunim të mirë me Shoqatat e dala nga lufta dhe iu ndihmojnë në mënyra të ndryshme përveç Komunës së Podujevës e cila nuk ka bërë asgjë në këtë drejtim, andaj lidhur me këtë deshta të shtroj një pyetje, a është e mundur që Komuna e Podujevës të paktën t’ju jap këtyre Organizatave në përdorim një zyrë ku do të zhvillonin aktivitetet e tyre. Duke u nisur nga fakti që këto kategori meritojnë kujdes institucional, unë propozoj që t’ju ndani të paktën një zyrë këtyre Organizatave të dala nga lufta për të kryer aktivitetet e veta që do t’ju bënte shumë nderë atyre por edhe më shumë do t’i bënte shumë nderë edhe vetë Komunës.

Gjithashtu propozoj që edhe Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, t’ju ndahen zyra ku do të mund të diskutonin çështjet që i shohin të nevojshme.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, drejtori i DA-së paraqiti një raport rreth bartjes së stafit nga objekti i vjetër i Komunës në objektin e ri, mirëpo ne po vërejmë se është një raport shumë i mangët dhe vetëm kemi një përshkrim që kjo Drejtori ka filluar e para kurse kjo Drejtori e fundit, pastaj flet për vonesa bartëse prej 1 muaji kur kemi pritur me vite për këtë Komunë. Përkundër vonesave të shumta e që keni premtuar që nuk do të hyni në objektin e ri të Komunës pa i sanuar të gjitha problemet, ky objekt është me probleme të shumta dhe që nuk i plotëson standardet, ta zëmë salla e Kuvendit ku jemi tani a i përmbush kushtet për një sallë të Kuvendit, çka nëse qytetarët dëshirojnë të jenë të pranishëm në sallë për të përcjellë seancat e Kuvendit të Komunës, ku është transparenca për qytetarët, problemet teknike që janë në këtë sallë, pastaj transmetimi dirket i seancave e që si

arsyetim e keni pasë Komunën e re duke thënë se janë të vendosura kamerat dhe do të transmetohen direkt seancat në ueb faqen e Komunës, pastaj çka keni menduar për veturat, këtu afër nuk ka asnjë parking për qytetarët të cilët kanë nevojë për të kryer ndonjë shërbim, në të kundërtën nëse parkohen do t'i duhej ta paguaj edhe dënimin e Policisë, jemi në vitin 2020 dhe nuk është ndërtuar para shumë viteve që të mos planifikohet parkingu. Mandej nuk keni jap informacione, shembull DKRS është bartur në këtë objekt dhe nuk jemi të njoftuar se çfarë do të bëhet me zyrat që janë atje ose Qendra Rinore siç i thoni ju, pastaj as edhe një informatë për gjendjen e objektit të vjetër të Komunës se a është tërheqë i gjithë materiali, nëse po përse që rreth 1 muaj nuk ka filluar të rinovohet asgjë, çka është plani të bëhet më atë objekt, cila pjesë po përfillet se do të rrënohet dhe a është dikush duke u përkujdesur për atë objekt sepse e dimë si bëhen objektet ku nuk rrinë askush. Po ashtu, i nderuari drejtor i DA-së, administratë janë edhe punëtorët e bibliotekës dhe ata të arkivit dhe nuk kemi asnjë informatë se përse nuk është bërë asnjë zgjidhje kur jemi në dijeni se në çfarë kushtesh të mjerueshme është arkivi, por sikurse nuk ekzistojnë fare për ju, por ata nuk kanë as ujë as tualet dhe duhen masa urgjente për ata punëtor ngase në qoftë se kalon nga ato zyra krijohet përshtypje e një objekti të braktisur dhe askush nuk mund të besoj se në atë vend gjenden dokumente shumë të rëndësishme por shumë të pambrojtura në atë objekt. Po ashtu kërkesat tona të mëhershme ka qenë që të ndahen zyra për grupe politike të Kuvendit të Komunës e që nga ju është thënë se në ish objektin e vjetër nuk ka vend por do të ketë në ndërtesën e re, andaj ne LVV kërkojmë një zyrë ku do të mund ta shfrytëzonim për takime me qytetarë.

Për fund, meqë jemi te Drejtoria e Administratës, si kërkesë tejet serioze dhe që është kërkesë e vazhdueshme edhe e qytetarëve është që administrata të mos e ndërpret pauzën nga ora 12:00 deri në ora 13:00, por të bëhet me rend, një pjesë prej 11:00 deri në 12:00 dhe pjesa tjetër prej 12:00 deri në ora 13:00, me qëllim që qytetarëve t'ju ofrohen shërbime me kohë, iniciativë e cila besoj se do të gjej mbështetjen e të gjithë asamblistëve.

z.Fatmir Rudari, theksoi, kam pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Administratës, dhe atë, a është planifikuar se çka do të ndodh me objektin e vjetër të Komunës. Nuk do të thotë që sot të marrim përgjigjen por kur do që mundet ai sepse edhe ne si këshilltarë të Kuvendit po kemi pyetje nga qytetarët dhe nuk po kemi përgjigje.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, edhe unë kam pyetje për afërsisht të njëjtë sikurse kolegu parafolës, a keni menduar për objektin e vjetër të Komunës se çka do të bëhet me atë, dhe a do të merren parasysh propozimet tona të bëra qysh në mandatin e kaluar që një pjesë e hapësirës të shfrytëzohet për galeri dhe atele në mënyrë që artistes Llapjan të shprehin talentin e tyre.

z.Gëzim Namani, drejtor i DA-së, theksoi, sa i përket dy pyetjeve të dy këshilltarëve paraprak mund t'ju them se për ndërtesën e ish Komunës ende nuk është vendosur se çfarë do të bëhet dhe të njëjtën përgjigje kanë marrë edhe Shoqatat e dala nga lufta edhe pse jemi në dijeni se ato Shoqata kanë pasë disa zyra në ish objektin e ashtuquajtur "objekti i Komitetit" i cili është rrënuar. Pra Shoqatat në fjalë kanë bërë kërkesë me shkrim, mirëpo ende nuk është vendosur se çka do të bëhet me objektin në fjalë për shkak se sa jam në dijeni ai objekt është futur nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit si trashëgimi kulturore dhe tani na mbetet të shohim se çfarë do të vendoset.

Sa i përket arkivit, ajo është pjesë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit por jo e Drejtorisë së Administratës por megjithatë ju njoftoj se së shpejti do të barten edhe ai staf besoj.

Sa i përket kushteve në këtë objekt të ri, unë e përmenda që një prej problemeve është zërimi në këtë sallë por që Komuna në këtë fazë paksa ka probleme me zhvillimin e procedurave të tenderimit për shkak të buxhetit kështu që jemi duke pritur konstituimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe institucioneve qendrore për tu mundësuar çështjet buxhetore respektivisht zhvillimin e procedurave përkatëse që ndërliken me buxhet. Pra përgjigja që thash se ende nuk është vendosur se çfarë do të

bëhet me ish objektin e Komunës, besoj që vlen edhe për disa prej pyetjeve që u parashtruan, ndërsa për arkivin e Komunës besoj se do t'i bëhet një vend hapësirë brenda këtij objekti duke përfshirë edhe materialin që posedon arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën si dhe gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura u jepen përgjigjet respektivisht u jepen sqarimet e nevojshme, e konstatojmë të mbyllur këtë pikë të rendit të ditës, dhe vazhdojmë me punë.

9. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2019

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e paraqiti raportin në fjalë, ndër të tjera theksoi, sa i përket raportit të punës së kuvendit për vitin 2019, konsideroj se në bashkëpunim me shefat e Grupeve të këshilltarëve të subjekteve që përfaqësohen në këtë Kuvend, si dhe në bashkëpunim me gjithë këshilltarët e Kuvendit, planin e hartuar bashkërisht me gjitha subjektet politike, e kemi realizuar në mënyrë të kënaqshme sipas dinamikës përkatëse, vlerësim ky i cili është bërë edhe nga Ministria përkatëse që monitoron punën e Kuvendeve të Komunave. Kur e them këtë, nuk e kam fjalën vetëm për numrin e mbledhjeve të mbajtura, mirëpo në këtë Kuvend ndër të tjera ka pasë edhe cilësi por edhe përmbajtje të kënaqshme. Jam në dijeni se ne kërkojmë dhe duhet të kërkojmë, duhet punojmë shumë më shumë sepse qytetarët e Komunës së Podujevës presin dhe kanë çka kërkojnë ky Kuvend në bazë të asaj që kanë dhënë mbështetjen për ne, por si do të jetë ai plani i punës ka qenë udhërrëfyes për ne si Kuvend dhe ka qenë ndihmë për ne, për dinamikën dhe përmbajtjen e seancave që kemi zhvilluar gjatë vitit 2019.

Pra kjo ishte vetëm si hyrje, ndërsa për çështje tjera, fjala është e juaja. Ju falënderoj në bashkëpunim dhe mbetemi me shpresën që në të ardhmen do të punojmë edhe më shumë dhe më fuqishëm në interes të të gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës.

z.Vendesin Lahu, theksoi, paraprakisht dëshiroj të falënderoj ish shefin e Grupit të këshilltarëve të LVV-së për punën e deritanishme. Kryesuesi i Kuvendit e lavdëroj raportin e punës së kuvendit gjatë vitit 2019 por unë kam disa vërejtje, në fakt në raport janë të dhënat rreth mbledhjeve të mbajtura si vlerësim pozitiv, mirëpo ajo që e konsiderojmë si vërejtje është se nuk është theksuar ajo çfarë nuk është bërë. E kemi hartuar planin e punës së Kuvendit për vitin përkatës i cili është zbatuar në një masë por në disa pika nuk është zbatuar, përkatësisht kanë qenë 35 pika të propozuara prej të cilave 7 nuk janë zbatuar ku prej tyre 4 pika janë më kryesoret e që nuk janë futur në kuadër të rendit të ditës në asnjë mbledhje. Unë po i përmendi disa prej tyre, e para dhe më e rëndësishmja mendoj se ka qenë 1-raporti i Kryetarit të komunës për gjendjen ekonomiko-financiare për vitin përkatës dhe zbatimin e planeve investuese, pikë e cila nuk është futur në rendin e ditës kur dihet se Kryetari ka obligim ligjor që 2 herë brenda vitit të raportoj para Kuvendit, 2-plani i detajuar i punës së prokurimit për vitin 2019, pikë e cila ka qenë e planifikuar në kuadër të planit të punës por që nuk është sjellë asnjëherë, pastaj 3-raporti i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin 2018 dhe planet për vitin 2019 e që asnjëherë nuk është sjellë në Kuvend si pikë e rendit të ditës edhe pse bashkërisht jemi dakorduar, si dhe 4-raporti i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë si dhe informatat rreth pronave publike në Komunën tonë, për të cilat po ashtu jemi dakorduar që të përfshihet si pikë e rendit të ditës dhe nuk kemi marrë informacionet e kërkuara.

Pra këto janë vërejtjet tona rreth këtij raporti dhe shpresoj se do të kemi përmirësim në këtë aspekt.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar këshilltarë tjerë për të marrë fjalën, e konstatojmë të përfunduar edhe këtë pikë të rendit të ditës dhe kalojmë në pikë e radhës.

10. Të ndryshme

z.Blerim Maqastena, theksoi, fillimisht kam pyetje për drejtorin z.Hamdi Jaha ose për z.Faik Muçiqi, fjala është për një projekt i cili për mendimin tim është shumë i mirë por realizimi i tij është jashtëzakonisht i dobët, përkatësisht vendosja e shtyllave për pengimin e detyrave në trotuare, kështu që lus të mos harxhoni mjete buxhetore më dhe ta ndalni atë projekt dhe të vendosni shtylla metalike për shkak se ato që janë vendosur veç kanë filluar të prishen, madje nuk ka rrugë ku nuk janë nga 3-4 shtylla të tilla që janë prishur dhe konsideroj se për një vit do të prishen të gjitha, andaj nëse do të gjej një mirëkuptim këtu do të isha i kënaqur me ju.

Pyetja e dytë është kjo, më 18 janar janë mbush 2 vite prej që nuk ka marrë pjesë në seanca të Kuvendit Kryetari i Komunës z.Agim Veliu, andaj do të doja një përgjigje nga Nënkryetari i Komunës ose nga z.Avni Fetahu si shef i grupit të këshilltarëve të subjektit politik LDK, apo edhe nga ju zotëri Kryesues i Kuvendit, përse gjithë ky injorim nga Kryetari i Komunës, madje unë kam pyetur edhe koleg nga Komuna tjera dhe nuk ka raste të tilla. Nuk do të thotë se kjo përgjigje patjetër të jepet sot, por nëse nuk mund të më jepni asnjëri prej juve që kërkova, do të doja përgjigjen ta marrë nga kolegu këshilltar z.Hasan Ajeti sepse ai duket si militant i frymës Rugoviane më së shumti nga ju të tjerët.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, kam një kërkesë nga banorët e fshatit Gllamnik lidhur me rrugën e quajtur “Qerim Toska” në afërsi shkollës, në gjatësi 300 m, e paasfaltuar, prandaj dëshirojnë ta dinë banorët se kur do të asfaltohet.

Pyetja tjetër ka të bëjë me fshatin Peran, pyetje e cila është bërë edhe disa muaj më parë e cila ka të bëjë me kyçjen e banorëve në rrjetin ujësjellësit, çështje për të cilën drejtori përgjegjës pati thënë se është vetëm çështje ditësh, por që kaloj një kohë e gjatë dhe ende nuk është bërë kyçja.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, kam një kërkesë për Drejtorisë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, që ka të bëjë me tarifën që e kanë bizneset përgjatë rrugës “Zahir Pajaziti”, konkretisht në rast se ka hapësirë ligjore të hiqet kjo tarifë gjatë periudhës kohore që po ndërtohet Bulevardi i qytetit.

z.Hasan Ajeti, theksoi, kam vetëm një kërkesë, referuar Ligjit për vetëqeverisje lokale, është kompetencë e pushtetit lokal për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve. Në një trajnim që kemi qenë një numër i këshilltarëve të Kuvendit, i cili është mbajtur në Prishtinë, dhe pas një diskutimi që kemi pasë me një drejtor të zyrës ligjore të Ministrisë përkatëse, ai ka thënë që përgjigjen që i kemi dhënë Komunës lidhur me këtë temë, është çështje që i përket Kuvendit të Komunës. Pra është nevojë që duhet të formohet një Komision i cili do të kishte për detyrë t’i shqyrtoj ankesat e qytetarëve lidhur me emërtimet e rrugëve.

Sa i përket mikut dhe kolegut tim socialdemokrat (Blerim Maqastena) u e respektoj dhe vlerësoj atë jashtëzakonisht shumë.

Meqë nuk pati këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:35

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0007408/20
Podujevë,
31 janar 2020**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi**